POSTIM ARKIVOR

# Dënimi i "sabotatorëve" të Kombinatit të Tekstileve "Mao Ce Dun", Berat, 1978

Procese politike të fundviteve '70




SEKSIONI

1970-1991

PERIUDHA

1978 - 1978

Në vitin 1977, në prag të shkëputjes së marrëdhënieve të Shqipërisë me Kinën, lufta ideologjike ishte përqendruar në armiqtë e brendshëm dhe alibitë për dështimet ekonomike. Në një qendër të rëndësishme industriale, në qytetin e Beratit, në kombinatin e tekstileve “Mao Ce Dun” (i ndërtuar në vitin 1966), rezultat i investimeve kineze), u zbulua dhe u dënua grupi i ashtuquajtur "i sabotatorëve". Procesi i dokumentuar në dosjet hetimore-gjyqësore nr. 11340 dhe 11340/I i përket grupit prej katër personash të arrestuar në vitin 1977 në Berat me akuzat e krijimit të organizatës kriminale, diversionit, tradhtisë ndaj atdheut dhe agjitacionit dhe propagandës. Ai u bë publik në kinoklubin e Kombinatit të Tekstileve dhe u dëgjua edhe nga të pranishëm jashtë nëpërmjet altoparlantit.

SABOTIM

KOMBINATI "MAO CE DUN", BERAT

KULAK

PERMBAJTJE #1

# Procesi gjyqësor i "Sabotatorëve të Beratit", 1978

Dy dosjet hetimore-gjyqësore nr. 11340 dhe 11340/I i përkasin grupit prej katër personash të arrestuar në vitin 1977 në Berat me akuzat e krijimit të organizatës kriminale, diversionit, tradhtisë ndaj atdheut dhe agjitacionit dhe propagandës, dy prej të cilëve u dënuan me vdekje dhe dy me dënime të rënda, 20 dhe 25 vjet burg. Procesi ishte një goditje e tri familjeve të cilësuara kulakë që vinte pas arrestimesh të tjera nga këto familje; në proces u përfshinë 11 dëshmitarë. Dosje hetuesie nr. 11340 për të pandehurit Ushtar Muço Çobo, Riza Ahmet Azizi, Luftëtar Sako Protoduari, Muharrem Sako Protoduari të cilët akuzohen: a) për pjesëmarrje në organizatë kriminale, b) tradhti ndaj atdheut; c) diversion; ç) agjitacion e propagandë kundër Pushtetit, në bazë të neneve 64, 70, 73/1 e 76 të Kodit Penal Dosja gjyqësore nr.11340/1 e Gjykatës së Rrethit Berat (kolegji ushtarak) për krijimin e një organizate kriminale, përgatitje për arratisje jashtë shtetit, diversion dhe agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor. Përshkruan procesin gjyqësor të katër të akuzuarve dhe vendimin e dënimit.

MEDIA #1

# Vendimi nr. 9, datë 28.1.1978 i Kolegjit Ushtarak të Gjykatës së Lartë

MEDIA FAQE #1



168

REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
" KOLEGJI USHTARAK "

Nr. 11 i Regj. Themeltar.
Nr. 9 i Vendimit.

V E N D I M
" NË EMËR TË POPULLIT "

Këshilli gjyqsor i kolegjit ushtarak të Gjykatës së Lartë, i formuar nën kryesinë e:

Aranit Çela Kryetar i Gjykatës së Lartë
me anëtarë: Eleni Selenica Zv.Kryetare e " " "
Ismail Lama Anëtar i " " "

në seancën e hapët gjyqsore me datë 28.I.1978 mori në shqyrtim çështjen Nr. 11 që i përket të gjykuarve:

1) USHTAR ÇOBO, [redacted]
i arrestuar më 25.7.1977.

2) RIZA AZIZI, [redacted]
i arrestuar më 4.7.1977

3) LUFTËTAR PROTODUARË, [redacted]
i arrestuar më 6.1.1977.

o/o

AIDSSH

Vendimi nr. 9, datë 28.1.1978 i Kolegjit Ushtarak të Gjykatës së Lartë

MEDIA FAQE #2

\- 2 -

4) MUHARREM PROTODUARI,

i dënuar për largim pa leje nga reparti ushtarak, i arrestuar më 27.4.1977.

TË AKUZUAR SE: Kanë formuar një organizatë kriminale kundër Pushtetit Popullor,në planin e së cilës kanë parashikuar dhe kanë bërë pregatitje për kryerje diversioni në Kombinatin e Tekstileve në Berat e për t'u arratisur jashtë shtetit dhe se kanë zhvilluar agjitacion e propagandë kundër Pushtetit Popullor, domethënë se kanë kryer krimet e parashikuara nga nenet 64, 70, 73/I në lidhje me nenin 76 të KP.

Me vendimin Nr. 1 datë 7.I.1978 kolegji ushtarak i gjykatës së rrethit të Beratit i ka deklaruar të gjykuarët fajtorë për të gjitha krimet dhe i ka dënuar:

1) Luftëtar Protoduarin në bazë të nenit 64 në lidhje me nenin 76 të KP me vdekje me pushkatim. Në bazë të nenit 70 në lidhje me nenin 76 të KP me vdekje me pushkatim. Në bazë të nenit 73/I në lidhje me nenet 76 dhe 28 të KP me 10 vjet heqje të lirisë dhe me humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

Përfundimisht në bashkimin e krimeve e ka dënuar Luftëtar Protoduarin me vdekje me pushkatim.

2) Riza Azizin në bazë të nenit 64 në lidhje me nenin 76 të KP me vdekje me pushkatim;

në bazë të nenit 70 në lidhje me nenin 76 të KP me vdekje me pushkatim; në bazë të nenit 73/I në lidhje me nenet 76 e 28 të KP me 10 vjet heqje të lirisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

Përfundimisht në bashkim të krimeve e ka dënuar Riza Azizin me vdekje me pushkatim.

3) Ushtar Çobon në bazë të nenit 64 në lidhje me nenet 76 e 28 të KP me 25 vjet heqje të lirisë, me konfiskim të pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë;

në bazë të nenit 70 në lidhje me nenet 76 e 28 të KP me 25 vjet heqje të lirisë, me konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë;

o/o

Vendimi nr. 9, datë 28.1.1978 i Kolegjit Ushtarak të Gjykatës së Lartë

MEDIA FAQE #3

\- 3 -

në bazë të nenit 73/I në lidhje me nenet 76 e 28 të KP me 10 vjet heqje të lirisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

Përfundimisht në bashkim të krimeve e ka dënuar me 25 vjet heqje të lirisë, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

4) Muharrem Protoduarin në bazë të nenit 64 në lidhje me nenet 76 e 28 të KP me 20 vjet heqje të lirisë, me konfiskim të pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë; në bazë të nenit 70 në lidhje me nenet 76 e 28 të KP me 20 vjet heqje të lirisë, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë;

në bazë të nenit 73/I në lidhje me nenet 76 e 28 të KP me 10 vjet heqje të lirisë dhe humbjen e së drejtës eletorale për 5 vjet kohë.

Përfundimisht në bashkim të krimeve e ka dënuar me 20 vjet heqje të lirisë, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

Kundër këtij vendimi kanë bërë ankim të gjykuarët Luftëtar Protoduari dhe Riza Azizi duke kërkuar ndryshimin e tij vetëm për masën e dënimit, për këto arsye:

Luftëtar Protoduari:

Fajësinë për krimet që jam dënuar e pranoj plotësisht.

Kam hyrë në rrugën e kriminalitetit i shtyrë nga të gjykuarit e tjerë dhe për shkak se kam qenë i paformuar politikisht.

Krijues i organizatës kriminale nuk kam qenë unë, por Ushtar Çobo sëbashku me Riza Azizin, prandaj kërkoj që dënimi me vdekje të ndryshohet duke mu kthyer me heqje lirie.

Riza Azizi:

Fajësinë e pranoj dhe atë e kam pranuar edhe në hetuesi.

Për shkak të prejardhjes jo të mirë politike u futa në rrugën e krimit, por dënimi me vdekje nuk i përshtatet rolit dhe pjesmarrjes time në krime. Gjykata nuk mbajti parasysh as pendimin tim në hetuesi.

Veprat e kryera kanë mbetur në tentativë, prandaj edhe ky fakt nuk është mbajtur parasysh nga gjykata në caktimin e dënimit.

o/o

Vendimi nr. 9, datë 28.1.1978 i Kolegjit Ushtarak të Gjykatës së Lartë

MEDIA FAQE #4



121

- 4 -

KËSHILLI GJYQSOR I KOLEGJIT USHTARAK
TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjoi relacionin e zëvëndëskryetares Eleni Selenica, dëgjoi prokurorin Qemal Lamaj, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit dhe pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Vendimi i kolegjit ushtarak të gjykatës së rrethit të Beratit si përsa i përket fajësisë të të katër të gjykuarve, kualifikimit ligjor të veprave penale të kryera prej tyre dhe llojit e masave të dënimit zbatuar për secilin të gjykuar, është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi.

Ka rezultuar e vërtetuar se të gjykuarit Ushtar Çobo , Riza Azizi dhe Luftëtar e Muharrem Protoduari, i pari nga fshati Polizhan dhe tre të tjerët nga fshati Poshnjë i rrethit të Beratit duke qënë elementë me origjinë shoqërore fshatarëëtë pasur (çifligarë) prindërit e të cilëve janë shpronësuar nga pushteti popullor dhe kanë edhe sot titullin kulak, të nisur nga predispozicioni i tyre armiqësor kundër Partisë dhe Shtetit tonë të diktaturës së rpoletariatit, në shtetor të vitit 1976 kanë krijuar një organizatë kriminale me synim kryerjen e krimeve kundër shtetit duke patur për qëllim minimin dhe dobësimin e pushtetit popullor.

Të ushqyer me ndjenjën e urrejtjes dhe armiqësisë kundër Partisë e Shtetit tonë prej prindërve të tyre të gjykuarit Ushtar Çobo, Riza Azizi dhe Luftëtar Protoduari edhe para krijimit të organizatës kriminale kanë zhvilluar për një kohë të gjatë midis tyre dhe me persona të tjerë biseda me përmbajtje armiqsësore.

Është vërtetuar se pasi të gjykuarit Ushtar Çobo iu arrestua babai (Muço Çobo), i cili tash është i dënuar për krimin e agjitacionit dhe propagandës kundër Pushtetit Popullor, si ka dëndësuar veprimtarinë e tij armiqësore. Kështu, në muajin Gusht të vitit 1976 si i propozon të gjykuarit Riza Azizi (djalit të hallës) që të arratisen sepse tani sipas tij "do t'u vijë edhe atyre radha për t'u arrestuar", propozim të cilin ky i fundit e pranoi. Të dy të gjykuarit e sipërm kanë biseduar që të punojnë për të

o/o

Vendimi nr. 9, datë 28.1.1978 i Kolegjit Ushtarak të Gjykatës së Lartë

MEDIA FAQE #5



172 (114)

- 5 -

afruar rreth vetes edhe persona të tjerë që janë të pakënaqur nga ky pushtet. Mbi këtë bazë, i gjykuari Riza i ka propozuar Luftëtar Protoduarit të bashkohet me grupin e tyre për të zhvilluar veprimtari armiqësore dhe këtë propozim e ka bërë duke njohur si origjinën e Luftëtarit ashtu dhe predispozicionin e tij armiqës[...] kundër pushtetit.

Të tre të gjykuarit e sipërm, siç rezulton nga provat e administruara, sidomos nga pohimet e shpjegimet e hollësishme të të gjykuarit Ushtar Çobo dhe nga pohimet e bëra në hetuesi prej dy të gjykuarve të tjerë Riza dhe Luftëtar, gjatë muajit shtator 1976 në katundin Poshnjë kanë bërë 3-4 mbledhje në të cilat kanë përpunuar platformën organizative dhe politike të veprimtarisë së tyre armiqësore.

Kështu ata, e kanë quajtur treshen e tyre si treshe kryesore dhe kanë zgjedhur si kryetar të saj të gjykuarin Ushtar Çobo; kanë vendosur që të zhvillojnë agjitacion e propagandë kundër Pushtetit Popullor me persona të tjerë; secili prej tyre të krijojë nga një treshe tjetër me persona të pakënaqur, por pa ekspozuar përbërjen e treshes kryesore; të gjykuarit Ushtar, Riza e Luftëtar duke qenë të vendosur për t'u arratisur, në mbledhjet e organizuara kanë menduar e caktuar rrugët e realizimit të arratisjes, duke vendosur që arratisjen t'a realizonin ose nëpërmjet qafës së Kazanit nga ana e Korçës ku i gjykuari Luftëtar ka pas kryer shërbimin ushtarak, ose nga Gjirokastra ku kishte kryer shërbimin ushta[r]ak i gjykuari Riza. Për të kryer arratisjen ata kanë vendosur që të sigurojnë edhe armë zjarri. Përveç sa sipër, të tre të gjykuarit kanë vendosur që para se të arratiseshin të kryenin një dëm të madh ekonomik duke hedhur në erë Kombinatin e Tekstileve në Berat dhe këtë veprim kriminal do ta kryenin edhe për faktin , siç pohojnë ata, për të bërë "jehonë" jashtë shtetit si edhe për të rritur "rëndësinë" e tyre para armiqve të jashtëm dhe me qëllim që autoritetet greke të mos i kthenin në Shqipëri. Për të kryer këtë diversion ekonomik i gjykuari Luftëtar u ngarkua të sigurojë dinamit. Duke pranuar këtë platformë organizative dhe politike, të gjykuarit Ushtar, Riza e Luftëtar kanë filluar të kryejnë veprime konkrete për të zbatuar platformën e tyre kriminale.

Kështu ata me një numur personash kanë zhvilluar biseda armiqësore duke mburur mënyrën e jetesës dhe "liritë" gjoja që gëzojnë njerëzit dhe sidomos rinia në vendet kapitaliste e revizio[...]

o/o

Vendimi nr. 9, datë 28.1.1978 i Kolegjit Ushtarak të Gjykatës së Lartë

MEDIA FAQE #6

173

- 6 -

niste dhe e kanë paraqitur të shtrëmbëruar jetën që bëhet në vendin tonë në tërësi dhe në fshatin socialist në veçanti, ku sipas tyre njerëzit vuajnë, punojnë shumë e marrin pak, mbizotëron arbitrariteti e padrejtësia, se Shqipëria është vend i mallkuar etj. Kanë folur se grupet armiqësore të Beqir Ballukut, Hito Çakos, Petrit Dumes, Abdyl Këllezit e Koço Theodhosit janë dënuar padrejtësisht; se komunistët zënë vende të privilegjuara dhe se të gjykuarëve "po ju ardhi koha", do t'u rrjepin komunistëve lëkurën.

E gjithë kjo veprimtari agjitative e propagandistike armiqësore është vërtetuar plotësisht me thëniet e dëshmitarëve A A , P B , A I , D e B M , me pohimet e bëra në hetuesi dhe në gjyq nga i gjykuari Ushtar Çobo si dhe me pohimet që të gjykuarit Riza e Luftëtar kanë bërë në hetuesi.

I gjykuari Luftëtar Protoduari, anëtari më i zellshëm për vënin në jetë të platformës kriminale, krijoi treshen e tij duke rekrutuar në veprimtari armiqësore vëllanë e tij, të gjykuarin Muharrem Protoduari dhe Përparim Berberin. Kështu, sikurse ka shpjeguar i gjykuari Muharrem, ai në muajt e verës ka ardhur disa herë me leje në shtëpi në kohën që ishte duke kryer shërbimin ushtarak. Pikërisht në këtë kohë, Luftëtari ka zhvilluar me të biseda me përmbajtje armiqësore dhe i ka propozuar, që kur ai të lirohej nga ushtria, të arratiseshin. Në muajin Shtator, pranon i gjykuari Muharrem, Luftëtari përsëri i ka propozuar për t'u arratisur duke i thënë se ka edhe shokë të tjerë. Ai i ka kërkuar të sigurojë armë që t'i kenë me vete kur të arratisen si dhe dinamit për të hedhur në erë Kombinatin. Për të gjitha këto, spjegon i gjykuari Muharrem, rashë dakort. Edhe P B i gjykuari Luftëtar i foli si për planin e arratisjes ashtu dhe për hedhjen në erë të Kombinatit, duke kërkuar prej tij gjetjen e vendit më të përshtatshëm ku do të vendosej dinamiti në Kombinat si dhe mbajtjen në shtëpinë e tij të armëve dhe dinamitit pasi ato të siguroheshin nga Muharremi. Për të gjitha këto fakte ka dhënë shpjegime të hollësishme e bindëse dëshmitari P B , i cili kishte pranuar propozimin e të gjykuarit Luftëtar që të bënte pjesë në organiza-

o/o

Vendimi nr. 9, datë 28.1.1978 i Kolegjit Ushtarak të Gjykatës së Lartë

MEDIA FAQE #7

174

115

- 7 -

tën kriminale. I gjykuari Muharrem Protoduari duke u bërë pjestar i organizatës kriminale ka zhvilluar agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor me dëshmitarët I S e G I , gjë që vërtetohet si me shpjegimet e këtyre ashtu dhe me pohimin e vetë të gjykuarit. Ky i fundit ka pohuar se ishte i vendosur për të siguruar armë e dinamit, por nuk mundi ta realizojë detyrën e ngarkuar sepse u arrestua dhe u dënua për krimin e largimit pa leje nga reparti, kurse më vonë u arrrestua edhe i vëllai i tij, Luftëtari.

Gjithashtu është vërtetuar se në Tetor 1976 të gjykuarit Ushtar, Riza e Luftëtar janë takuar një ditë në qytetin e Beratit dhe të tre kanë vendosur të shkojnë në Kombinat për të parë nga afër e për të saktësuar vendin se ku do të vendosnin dinamitin. Ata, pasi kanë shkuar atje, të tre sëbashku, kanë caktuar si vënd më të përshtatshëm, nga ku mund të shkaktohej një dëm më i madh, vendosjen e dinamitit ose minave në territorin e kaldajës dhe të depozitave të lëndës djegëse të Kombinatit.

Në rrethanat e mësipërme gjykata me të drejtë ka pranuar se të gjykuarët kanë pas krijuar një organizatë kriminale me një platformë të caktuar organizative e politike me qëllim për të kryer disa krime kundër shtetit. Gjithashtu ajo me të drejtë ka pranuar se në veprimet e të gjykuarve ekzistojnë elementet e krimit të pregatitjes për tradhëti ndaj Atdheut në formën e arratisjes, elementët e krimit të pregatitjes për të kryer diversion si dhe elementet e krimit të agjitacionit e propagandës kundër Pushtetit Popullor.

Fajësia e të gjykuarve është vërtetuar plotësisht me thëniet e një seri dëshmitarëve, me pohimet e plota në hetuesi dhe në gjyq të bëra nga të gjykuarit Ushtar Çobo e Muharrem Protoduari.

Gjykata drejtë ka bërë edhe individualizimin e dënimeve për të gjykuarit. Megjithse ajo pranon në vendimin e saj se i gjykuari Ushtar Çobo ka qenë kryetar i organizatës kriminale, në fakt, tërësia e provave dhe vetë veprimet e kryera kanë vërtetuar se të gjykuarit Luftëtar Protoduari dhe Riza Azizi kanë qënë nga antarët më aktivë të organizatës duke ia kaluar edhe kryetarit të tyre.

Gjykata në caktimin e llojeve dhe masës së dënimit për

o/o

Vendimi nr. 9, datë 28.1.1978 i Kolegjit Ushtarak të Gjykatës së Lartë

MEDIA FAQE #8



175

- 8 -

secilin të gjykuar ka mbajtur mirë parasysh rrezikshmërinë e përgjithshme të veprave penale të kryera nga të gjykuarët dhe shkallën e rrezikshmërisë konkrete, rrezikshmërinë shoqërore që paraqesin vetë të gjykuarit, njerëz me prejardhje nga klasat e shpronësuara (kulakë) prindërit e të cilëve (baballarët) kanë qenë të lidhur me okupatorin dhe të rrjeshtuar në rradhët e organizatës tradhtare të "Ballit Kombëtar", të dënuar ose të arrestuar tani për krime kundër shtetit. Edhe vetë të gjykuarit të edukuar me ndjenjën e armiqësisë dhe urrejtjes kundër Pushtetit Popullor, me gjithëse të rinj në moshë, kanë patur predispozicion të theksuar armiqsor, kanë ëndëruar për të kaluarën e "humbur" të prindërve dhe gjatë gjithë kohës kanë bërë një jetë të degjeneruar e parazitare.

Të gjykuarit Luftëtar Protoduari dhe Riza Azizi kanë qenë anëtarët më aktivë të organizatës kriminale. Ata megjithëse në hetuesi kanë shpjeguar veprimtarinë e tyre kriminale në gjyq kanë mohuar kryerjen e krimeve dhe kanë mbajtur një qëndrim të egër e cinik duke dashur që me këtë veprim të tyre të venë në dyshim procesin hetimor. Dënimi me vdekje që gjykata u ka caktuar këtyre të gjykuarve është plotësisht i justifikueshëm.

Pretendimet e tyre për t'iu kthyer dënimi me vdekje në heqje të lirisë janë të pabazuara. Gjykata i ka mbajtur ato parasysh, prandaj nuk ka vend për zbutjen e masës së dënimit.

PËR KËTO ARSYE

Këshilli gjyqsor i kolegjit ushtarak të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të nenit 313 pika 1 të K Pr P,

V E N D O S I

Lënien në fuqi të vendimit Nr.1 datë 7.I.1978 të kolegjit ushtarak të Gjykatës së rrethit Berat.

Vendimi për të dënuarit me vdekje Luftëtar Protoduari dhe Riza Azizi nuk mund të ekzekutohet pa marrë përgjigjen e lutjeve të tyre për falje nga Presidiumi i Kuvendit Popullor.

Tiranë, më 28.I.1978.

| | | |
|---|---|---|
| A n ë t a r e | A n ë t a r | K r y e s u e s i |
| /E.Selenica/ | /I.Lama/ | /A. Çela/ |

Vendimi nr. 9, datë 28.1.1978 i Kolegjit Ushtarak të Gjykatës së Lartë

INFORMACION

# Vendimi nr. 9, datë 28.1.1978 i Kolegjit Ushtarak të Gjykatës së Lartë

| | |
|---|---|
| VENDIM | Nr. 9, datë28.1.1978 |
| GJYKATA | Këshilli Gjyqësor i Gjykatës së Lartë Ushtarake |
| ANËTARËT | Aranit Çela (kryetar i Gjykatës së Lartë), Eleni Selenica (zv.kryetare), Ismail Lama (anëtar) |
| FONDI | Hetimor-gjyqësor |
| DOSJA | 11340.1 |
| VITI | 1978 |
| SASIA E FLETËVE | 6 |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

# Dokument me shkrim dore

MEDIA FAQE #1



(1) F.-1 106 (61

Dëgjova me vëmëndje trupin gjykues, të pandehurin dhe dëshmitarët dhe me indinjatë të thellë dënoje pikpamjet armiqësore të të pandehurit, i cili në mënyrë krejt të paturpshme gënjenë dhe nuk tregonë realitetin në ushtrinë tonë popullore, ai këtë e ka bërë qëllimisht për të çoroditur mendjen e ushtarëve të tjerë që ata të mos kryejnë detyrat duke u mbështetur në vijën e Partisë. I pandehuri thotë se në ushtri është vendosur diktatura. Po për cilën diktaturë flet ai? Ushtria dhe diktatura kanë karakter klasor, mbronë interesat e klasës në fuqi. Tek neve diktatura e prolet. është diktaturë për pakicën dhe demokraci për shumicën, është diktaturë e shumicën mbi pakicën.
I pandehuri nuk e duronte dotë rregullin e disiplinën. Ai i kundërvihesh vijës së Partisë në ushtri, dhe për këtë të pandehur duhet të këtë megjithmënd diktaturë. Ky është armiku i klasës që synonë të minojë diktaturën e proletariatit, synonë të prish disiplinë inkurajonë anarshinë në ushtri e kudo dhe për këtë grushti i hekurt i diktaturës së proleta.

AIDSSH

Dokument me shkrim dore

MEDIA FAQE #2



F 2. 107 (62

do ti shtypë si krimbat e plehut këta armiq të klasës.
I pandehuri shprehet se-«Në kohën e Beqirit Ballukut kishte liri dhe behej qejf». Po për çfar lirie behet fjalë more shokë! Përkundrazi në kohën e Beqir Ballukut u vendos burgu, megjith punën e madhe që behej nga ana e partisë ata, pra grupi puçist e tradhetar, punuan për të dobësuar organizatën e Partisë, rolin e saj udhëheqës në ushtri, për të zëvëndësuar ideologjinë marks-lenin. të Partisë tonë me atë revizioniste. Ata u munduan të futin metoda të urryera të ushtrive borgjeze siç ishte dhe burgu. Por i pandehuri pajtohesh me këto metoda të armiqve dhe me qëllimet e tyre, prandaj ai thotë se kishte liri e bëhej qejf. Por në të vërtet çndodhë dhe kush është fakt. Ndodh krejt e kundërt. Ushtria jonë është një ushtri e veçantë nga të gjitha ushtritë e botës, ajo është ushtri e popullit, që udhëhiqet nga ideologjia e partisë. Kuadrot me ne sillen si vëllai me vëllanë, si prindi me djalin dhe ata na japin neve ndihmën

AIDSSH

Dokument me shkrim dore

MEDIA FAQE #3

F. 3 108

(63)

e nevojshme për kuptimin dhe zbatimin
e detyrave me përpikmëri. Ata kanë
zhdukur çdo distancë me neve në ushtri tani
nuk ka prepotencë e arrogancë, ata na edu-
kojnë gjithmonë me shëmbullin personal, kujdesi
atëror i tyre për ne nuk mungonë kurrë.

I pandehuri thotë se «Nuk na lenë rehat
as kapterat». Ky nuk i duronte dotë nënoficerët
e shërbimit të detyrueshëm dhe i pelqente ti
thërriste kaptera. Por Partia i hoqi gradat
në ushtri. Nënoficerët janë ata që kërkojnë
zbatimin e të gjithave detyrave e rregulloreve
në ushtri. Duke mos i duruar të gjitha
këto, ai thotë në shënje përbuzje që sna lënë
rehat kapterat.

I pandehuri thote se «Disiplina në ushtri
është disiplinë frike.» Nuk është aspak e
vërtetë. Bazën e vërtetë të disiplinës në ushtrinë
tonë e përbënë ndërgjegja e lartë revolucionare.
Ajo është një disiplinë e vetëdijshme proletare
që buronë nga ideologjia marks-lenin. e
Partisë sonë. Disiplina frike dhe disiplinë
e kërbaçit është vetëm në ushtritë borgjeze
e revizioniste. Tek ne disiplina e ndërgjegjshme

Dokument me shkrim dore

MEDIA FAQE #4

F 4. 109

(64)

është burim force, organizimi, frymëzimi dhe
mobilizimi për kryerjen e çdo detyre me ndjenje
të lartë përgjegjësie. Neve po e provojmë vetë,
sa herë që oficeri le ndonjë detyrë, ne e kye-
jmë me ndërgjegje. Eshtë fakt që thyerjet
disiplinore janë pakësuar shume. Ushtaret, me
kujdesin e madh të Partisë, e bëjnë shërbimin
ushtarak në rrethin e tyre dhe thyerjet e
disiplinës si ikjet pa leje nuk kemi, thyerje
të shërbimit të rojës dhe thyerje ~~të shërbimit~~
~~të~~ të rregullit të brendshëm. Të gjitha këto
jo se ne e kemi nga frika, aspak, por kjo
është disiplinë e ndërgjegjshme dhe ne
jemi të ndërgjegjshëm se, zbatimi i detyrave
i urdhërave dhe i udhëzimeve është i lidhur
me dëshirat, fatet dhe interesat e atdheut.
I pandehuri thotë se «Në ushtri po levize
këmbën të presin kokën»
Eshtë e vërtetë se në ushtri po nuk ece
me vijën e Partisë, po tu kundërvihesh

ushtari

D[redacted]

B[redacted]

Dokument me shkrim dore

INFORMACION

## Dokument me shkrim dore

| | |
|---|---|
| FONDI | Hetimor-gjyqësor |
| DOSJA | 11340.1 |
| VITI | 1978 |
| HAPËSIRA GJEOGRAFIKE E VEPRIMTARISË | Berat |
| KRIJUAR NGA | D.B. |
| SASIA E FLETËVE | 4 |
| GJUHA | Shqip |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #3

# Dokument me shkrim dore me tri fletë

MEDIA FAQE #1



110 ~~200~~ (65)

(2)

Si anëtar i organizatës së Bashkimit të Rinisë së Punës së Shqipërisë e quaj të domosdoshme të them edhe unë disa fjalë. Nga deponimet e të pandehurve dëgjova të flitet edhe për rininë. Dëgjova të thuhej këtu se ndërsa në vëndet borgjezo revizioniste rinia është "e lirë" të bëjë ç'të dojë e të veprojë si të dojë, të shijojnë jetën, sipas tyre, në të gjitha aspektet e saj, duke ndjekur modën, duke patur liri mendimi e veprime, ndërsa këtu tek ne nuk ndodh një gjë e tillë, sepse këtu paska diktaturë dhe rinia nuk ka liri mendimi. Të njëjtat [illegible] mendime llomotit edhe propoganda e vëndeve borgjezo-revizioniste, se gjoja tek ne mungon "liria" e "personaliteti" i brezit të ri. Po për ç'farë lirie e personaliteti mund të bëhet fjalë në vëndet borgjezo-revizioniste kur masa të tëra të rinisë enden rrugëve të papuna e pa shpresë, kur ndërsa dyert e shkollave janë të mbyllura, kishat dhe institucionet e shumta fetare të marrin frymën, kur qoshkave e rrugëve, natë e ditë, vërtiten narkomanë, rrugaçë, vjedhës e vrasës, që

Dokument me shkrim dore me tri fletë

MEDIA FAQE #2



kryejnë krime [illegible] në përpjestime përherë e më të mëdha. 111 ~~201~~ (66)

Bashkimi i rinisë e edukon brezin e ri që ta dojë si dritën e syve Atdheun, diktaturën e proletariatit, Partinë që kanë sjellë këto ditë të bukura, të gëzuara e të lumtura. Na qajnë hallin armiqtë e të gjitha ngjyrave, se rinia jonë vuaka gjoja në diktaturën e proletariatit, mundohet e s'gëzoka "liritë" e "mundësitë e mëdha" që na paskërka e ashtuquajtura "demokraci borgjeze". Rinia jonë këtyre zotërinjve u përgjigjet me shprehjen popullore "Mos i qani hallin kalorësit se i varen këmbët. Është diktatura e proletariatit që për mbi 3 dekada, po rrit e lulëzon në Shqipëri një brez të ri, të lumtur e të lirë. Diktatura e proletariatit na ka dhënë e na jep falas shkollën e mjekimin shëndetësor, na jep punën. Tek diktatura e proletariatit shohim të sotmen e të ardhshmen tonë të sigurtë, ndaj e kemi detyrë të shenjtë që nën udhëheqjen e Partisë, të qëndrojmë gjithënjë në ballë të luftës klasore, për ta forcuar e mbrojtur atë si sytë e ballit

Dokument me shkrim dore me tri fletë

MEDIA FAQE #3


202/112

Udhëheqësi ynë i madh shoku Enver Hoxha na mëson: "Ne duhet të spastrojmë deri në fund skoriet, duhet të spastrojmë me idealin tonë, me idetë tona marksiste-leniniste." Pikërisht [illegible] folklorin tonë.

(67)

Ne do të përmbahemi si kurdoherë këtyre mësimeve dhe do ti veme këto në jetë dhe u themi armiqve"

Tek ne nuk do të gjejnë asnjë të çarë sepse do të vëmë si barrikadë si kurdoherë kallot në duart tona.

D[redacted] Z[redacted]

(2)

AIDSSH

Dokument me shkrim dore me tri fletë

INFORMACION

## Dokument me shkrim dore me tri fletë

| | |
|---|---|
| FONDI | Hetimor-gjyqësor |
| DOSJA | 11340.1 |
| VITI | 1978 |
| HAPËSIRA GJEOGRAFIKE E VEPRIM-TARISË | Berat |
| KRIJUAR NGA | D.Z. |
| GJUHA | Shqip |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #4

# Dokument me shtatë fletë, me numër rendor 113-119

MEDIA FAQE #1



-1- 203 113 (68

populli i ynë ka luftuar vazhdimisht për të
ruajtur ekzistencën e tij, për një jetë të lirë e të
denjë njerëzore, për të ruajtur traditat fisnike
dhe kulturën e tij të lashtë. Dallgët e pamëshirshme
të jetës s'e thyen dot kurrë as vullnetin e tij
të hekurt dhe optimizmin revolucionar as
humorin e tij të hollë dhe ndjenjën e së bukurës.
Pushken, këngën, vallen ai i ka bërë pjesë të
pa ndara të jetës.
Arti dhe kultura të na i shërbejnë popullit.
Në vendin tonë është krijuar një bazë e shëndoshë
dhe e gjithanshme në fushën e artit dhe të letërsisë.
Popullit duhet t'i japim sa më shumë vepra të bukura.
të frymëzuara nga jeta jonë heroike.
Vendi ynë është i rrethuar nga armiqtë e egër
imperialist e revizionist. Ideollogjia e tyre
përpiqet të depërtojë në këto sektorë, sepse edhe
që kanë një rëndësi të madhe për edukimin ~~popull~~
e popullit.
Armiqtë ~~tanë~~ nuk e kanë pushuar kurr agresionin
Ideollogjik në drejtim të degjenerimit të njerzëve
tonë. Ata s'ja kanë arritur dhe s'do t'ja arrijnë
kurr qëllimeve të tyre sepse partia dhe shoku
Enver na i kanë bërë të kjartë vijën në drejtim të

Dokument me shtatë fletë, me numër rendor 113-119

MEDIA FAQE #2



-2- 114 (69

letërsisë dhe Arteve, sepse populli ynë është i
lidhur si mishi me kockën me partinë dhe shokun
Enver. Në vendin tonë Artet ~~tona~~ dhe letërsia
kanë karakter të partishëm, klasor, masiv e
popullor.
Muzika dhe folklori ynë janë një thesar i madh
për ne, mbi të cilin janë mbështetur dhe mbështeten
kompozitorët tanë të talentuar që kanë krijuar
e krijojnë vepra dhe këngë të bukura ~~dhe~~
me vlerë që pëlqehen jo vetëm në vendin tonë
por edhe jashtë atdheut.
Marksizëm-Leninizmi dhe mësimet e shokut Enver
janë baza e ideollogjisë ku mbështeten shkrimtarët
dhe Artistët tanë për të krijuar veprat e tyre
të bukura. Dihet se muzika në çdo vend, ka
shprehur karakteristikat e jetës dhe shpirtit së popullit.
~~këtë mund~~ Këtë mund ta shohim qoft në folklor,
qoft në muzikën e përpunuar. Me to janë pasqyruar
kurdoherë ndjenjat dhe aspiratat e popullit.
Gjatë procesit të zhvillimit ne ruajmë në folklorin
dhe muzikën e përpunuar karakteristikat kombëtare
dhe forcojmë përmbajtjen socialiste-

Dokument me shtatë fletë, me numër rendor 113-119

MEDIA FAQE #3



-3- 115 (70

folklori, jeta dhe psikollogjia e popullit dhe veçoritë e vendit, duke përfshirë dhe veçoritë e natyrës; lenë vulën e tyre mbi muzikën e një vëndi dhe e bejnë atë të dallohet nga muzika e vendeve të tjera. Muzika e jonë krahas tipareve të reja të shoqërisë socialiste shpreh edhe tiparet e natyrës sonë. Pranoj Muzika e jonë eshtë e freskët si burimi në male, e fortë si populli ynë trimë e Heroikë.

Shqiptari s'ka qenë kurrë soditës i thjeshtë i jetës, imitues, skllav i verbër i kulturës të të tjerëve. Gjithmon ka qenë dhe aq më tepër Sot ai është aktiv ndaj saj dhe jep kontributin e tij në kulturën revolucionore Botërore. Ne kemi kengëtorë dhe instrumentistë shumë të mirë që kanë habitur Botën me artin tonë revolucionar me përmbajtje dhe i përsosur nga forma Artistike.

Karakteristikë e artit tonë socialist është dhe masiviteti si në qytete dhe në fshatra.

Me dhjetra janë ansamblet dhe estradat që janë ngritur në ndërmarrjet ekonomike dhe kooperativat Bujqësore, Ato me çfaqjet e tyre kontribuojnë në edukimin komunist të masave të punonjëse të qytetit dhe fshatit.

Dokument me shtatë fletë, me numër rendor 113-119

MEDIA FAQE #4



-4- 116 (71

Këto ansamble janë pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme për një veprimtari të mirë artistike. Objekt i Artit tonë është njeriu ynë i ri me gjithë kompleksitetin e tij.

Këndej rrjedh dhe roli i madh që luajnë artet në kalitjen e ndërgjegjes dhe përpunimin e saj, lidhur ngushtë me periudhën që ne po kalojmë, me përpjekjet, me luftën për të shpartalluar Bllokadën e egër imperialisto-revizioniste. Lidhur me këtë problem Shoku Enver theksoi: "Bazë e krijimtarisë, si për çdo gjë, ashtu edhe në art e në kulturë është Baza popullore në popull ne duhet të gjejmë frymëzimin tonë, Tingujt e këngës, ritmet e valles.."

Partia dhe Shoku Enver kanë theksuar shumë herë rëndësinë e folklorit dhe të instrumentave popullore veshjeve popullore.

Armiqtë e popullit Fadil Paçrami dhe Todi Lubonja mbanin qëndrim përbuzës ndaj folklorit, Muzikës popullore dhe instrumentave popullore; qëndrim të cilin e gjejmë dhe e shohim të mbojnë edhe armiqtë që janë vënë në bangon e të Akuzuarve.

Dokument me shtatë fletë, me numër rendor 113-119

MEDIA FAQE #5



— 5 —

117 (72

partia e jonë, i përmbahet me vendosmëri parimit Leninist të partishmërisë proletare në fushën e artit, të kulturës dhe të gjithë jetës shpirtërore të shoqërisë.

Letërsia dhe Arti ynë nuk kanë lindur në një vend të zbrazët, por mbi bazën e zhvillimit të gjatë historik të shoqërisë sonë.

Edhe kënga si gjini më e përhapur dhe e zhvilluar në gjirin e popullit në etapat të ndryshme ka shprehur me vërtetësi kushtet Historiko-shoqërore nëpër të cilin ka kaluar Shoqëria tek ne.

Në etapën e ndërtimit të socializmit kënga e jonë fitoi cilësi të reja në përmbajtje dhe në formë në luftë kundër ideologjisë Borgjezo-Revizioniste.

Këngët tona si ato popullore dhe të kompozuara kanë një burim të vetëm, ato mishërojnë idealet ~~[illegible]~~ e partisë sonë në luftë për ndërtimin e socializmit dhe komunizmit në kushtet e rrethimit të egër imperialisto-Revizionist, ato zhvillohen në bazë të drejtë dhe frymëzohen nga Heroizmi i popullit tonë.

Në kushtet e ndërtimit të socializmit me forcat tona kënga u bë bashkëudhëtare e jetës sonë Heroike.

AIDSSH

Dokument me shtatë fletë, me numër rendor 113-119

MEDIA FAQE #6



— 6 —

118 (73

Tradhëtarët e partisë dhe të popullit tonë Fadil Paçrami dhe Todi Lubonja i shtrëmbëronin direktivat e partisë për artin dhe letërsinë.

Shoku Enver në fjalën e mbylljes në plenumin e IV-të të K.Q. të P.P.SH. ka thënë:

" Dihet Historikisht se viti 1960 ishte fillimi i luftës së hapët frontale heroike të partisë sonë kundër revizionizmit Modern Sovjetik dhe Botëror, ishte lufta për jetë a vdekje e partisë dhe popullit tonë trim kundër Bllokadës Revizioniste-kapitaliste ".

Mbi këtë Bllokadë të egër ne duolëm fitimtarë dhe fitimtarë do të marshojmë kurdoherë nën udhëheqjen e partisë.

Mbas plenumit të IV. të K.Q. të P.P.SH. shpërthen me gjithë forcën e bukurinë e tij Arti ynë socialist.

U krijuan shumë romane Drama, opera e Balete, Simfoni, kantata dhe këngë masash. Një zhvillim të mirë mori dhe kinematografia. Ansamblet tona artistike korrën sukseset të Bujshme edhe jashtë Atdheut tonë.

Një zhvillim të vrullshëm mori edhe arti amator në ndërmarrje dhe kooperativa Bujqësore.

AIDSSH

Dokument me shtatë fletë, me numër rendor 113-119

MEDIA FAQE #7



\- 7 -

11P (74)

Edhe në rrethin tonë ashtu si në mbarë atdheun partia dhe pushteti i japin një rëndësi të madhe zhvillimit të letërsisë dhe artene-
Përveç shtëpisë kulturës "Margarita Tutulani", klubit të kombinatit dhe atij të qytetit Stalin që zhvillojnë ~~[illegible]~~ një aktivitet të përmishëm artistike një rol të madh në edukimin komunist të kooperativistevë lozin shtëpit e kulturës në fshatra.
Çdo fshat ka grupin e vet artistike të pajisur ~~[illegible]~~ me të gjitha mjetet e nevojshme për të zhvilluar një veprimtari të mirë artistike.
Një dëshmi për këtë zhvillim është edhe inagurimi i shtëpisë se të kulturës në kooperativën e Poshnjës ku marin pjesë me dhjetra të rinjë e të rinjë në aktivitetet e ndryshme kulturore artistike. Arti dhe kultura jonë kombëtore do të ecin gjithmonë përpara se ato ~~[illegible]~~ i prijnë mësimet e partisë dhe shokut Enver.

S K

Dokument me shtatë fletë, me numër rendor 113-119

INFORMACION

## Dokument me shtatë fletë, me numër rendor 113-119

| | |
|---|---|
| FONDI | Hetimor-gjyqësor |
| DOSJA | 11340.1 |
| VITI | 1978 |
| GJUHA | Shqip |
| HAPËSIRA GJEOGRAFIKE E VEPRIMTARISË | Berat |
| KRIJUAR NGA | S.K. |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

# Foto

MEDIA FAQE #1




Foto

MEDIA FAQE #2



Foto

INFORMACION

# Foto

| | |
|---|---|
| FONDI | Hetimor-gjyqësor |
| DOSJA | Nr. 11340.1 |
| VITI | 1978 |
| HAPËSIRA GJEOGRAFIKE E VEPRIMTARISË | Berat, kombinati "Mao Ce Dun" |
| LLOJI I DOKUMENTIT | Foto |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #6

# Gjyqi i të deklasuarve nga Poshnja

MEDIA FAQE #1

### Video e bashkangjitur

https://localhost:3000/get-asset/f8ca5bb5-dded-4a06-8111-a63a96e0144f

INFORMACION

## Gjyqi i të deklasuarve nga Poshnja

Autoret: AQSH

| | |
|---|---|
| BURIMI | |
| HAPËSIRA GJEOGRAFIKE E VEPRIMTARISË | Berat, kombinati "Mao Ce Dun" |
| DATË | 6 dhe 7 janar 1978 |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #7

# Kapaku i dosjes së hetuesë nr. 11340

MEDIA FAQE #1


Republika Popullore Socialiste e Shqipersë
Ministria Punëve të Brendshme
Dega Punëve të Brendshme
Berat

Nr. regj. 176

11340

Dosje e hetuesise

per të pandehurit

1.- Ushtar Muço Çobo.
2.- Riza Ahmet Azizi.
3.- Luftëtar Sako Protoduari.-
4.- Muharem Sako Protoduari.-

Akuzohen:

a) Për pjesemarje në organizate kriminale.-
b) Tradheti ndaj atdheut.-
c) Diversion.-
ç) Agjitacion e propagandë kunder Pushtetit.-

në bazë të neneve:

64 ; 70 ; 73/I ; e 76 të kodit Penal.-

347 fl.

Data e fillimit 15. Janar 1977
Data e mbarimit 27 Gusht 1977

Hetuesi
(Bujar Himçi)

AIDSSH

Kapaku i dosjes së hetuesë nr. 11340

INFORMACION

## Kapaku i dosjes së hetuesë nr. 11340

| | |
|---|---|
| FONDI | Hetimor-gyqësor |
| DOSJA | Nr. 11340 |
| VITI | 1977 |
| NUMRI I FAQEVE | 397 |
| HAPËSIRA GJEOGRAFIKE E VEPRIMTARISË | Berat |
| STRUKTURA | Dega e Punëve të Brendshme Berat |
| HETUESI | Bujar Himçi |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #8

# Kapaku i dosjes gjyqësore

MEDIA FAQE #1


VITI 1977

11340/I

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPERISË
GJYKATA E LARTË

GJYKATA E Rrethit Berat (Kolegji ushtarak)

Nr. Regj. Them. 187/3
Data e ardhjes 18.10.77

Nr. vendimit 1
Data 7.1.78

Të pandehur

Akuza

Gjyqtar

AIDSSH

Kapaku i dosjes gjyqësore

INFORMACION

## Kapaku i dosjes gjyqësore

| | |
|---|---|
| FONDI | Hetimor-gjyqësor |
| STRUKTURA | Gjykata e Rrethit Berat |
| DOSJA | 11340.1 |
| VITI | 1978 |
| HAPËSIRA GJEOGRAFIKE E VEPRIMTARISË | Berat |
| TRUPI GJYKUES | Ali Zanko (gjyqtar), Nexhip Nanushaj (ndihmësgjyqtar), Sofokli Tere (ndihmësgjyqtar) |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.